



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.57

2004

17 Gusht

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Dekret nr.4283 datë 27.7.2004	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	3727
Dekret nr.4288 datë 29.7.2004	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3728
Vendim i KM nr.496, datë 23.7.2004	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Kroacisë, për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes së mjedisit.....	3728
Udhëzim i MRRTT nr.4 datë 11.8.2004	Për mënyrën e ushtrimit të kompetencës për planifikimin e territorit nga njësitë e qeverisjes vendore.....	3731
Udhëzim i MF nr.7/1, datë 3.8.2004	Për një ndryshim në udhëzimin nr.7, datë 10.2.2004 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar".....	3734
Udhëzim i MF nr.8, datë 28.7.2004	Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim taksave.....	3735
	Shpallje shtesë kërkesë shpronësimi me objekt ndërtimin e segmentit rrugor Lezhë-Balldre, seksioni i parë.....	3751

Shpallje kërkesë shpronësimi me objekt ndërtimin e kanaleve kulluese-vaditëse, të dëmtuara nga ndërtimi dhe rehabilitimi i segmentit rrugor Kakavijë-Gjirokastrë.....	3753
Shpallje shtesë kërkesë për shpronësim me objekt ndërtimin e segmentit rrugor Elbasan-Librazhd.....	3757
Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt sistemimin dhe ndërtimin e rrugës Ibrahim Dimçi në qytetin e Elbasanit.....	3759

DEKRET
Nr.4283, datë 27.7.2004

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|---------------------------------------|
| 1. Miranda Gëzim Klindtworth (Shima) | 29. Arben Abdullah Ferizoviqi |
| 2. Xhemali Ibrahim Dizdari | 30. Irida Gëzim Schmidlechner (Dibra) |
| 3. Egni Xhemali Dizdari | 31. Teuta Zyber Rapi (Gjeropi) |
| 4. Emine Raif Dizdari (Belba) | 32. Norbi Dhimitri Rapi |
| 5. Elked Xhemali Dizdari | 33. Lerbi Gregor Dhimitri Rapi |
| 6. Besmir Xhemali Dizdari | 34. Miranda Ymer Dragusha (Muja) |
| 7. Xhevahir Haki Fejzo | 35. Aredi Ragip Dragusha |
| 8. Hysen Ymer Jampert (Myrto) | 36. Nensi Ragip Dragusha |
| 9. Rrustem Lil Limani | 37. Majlinda Nesmi Umbach (Mullai) |
| 10. Egzon Rrustem Limani | 38. Gerina Nezir Stechow (Uku) |
| 11. Engjellushe Osman Dappert (Rrahmani) | 39. Elton Niazi Luli |
| 12. Adile Qazim Nunaj | 40. Eduard Mark Barth (Doda) |
| 13. Anila Iliko Kreibich (Çave) | 41. Andi Vladimir Shpuza |
| 14. Marissa Karl Kreibich | 42. Iva Robert Widmer (Shuli) |
| 15. Elisabeta Zenel Hoxha | 43. Genc Petrit Kasmi |
| 16. Sonja Alfred Spaho | 44. Petrit Genc Kasmi |
| 17. Franko (Franco) Alfred Spaho | 45. Nergin Genc Kasmi |
| 18. Sherina Alfred Spaho | 46. Nertila Adem Kasmi (Hajri) |
| 19. Rita Sherif Keçi | 47. Luan Haxhi Lapi |
| 20. Ejrun Mustafa Korusi | 48. Judmir Nuri Meta |
| 21. Rezarta Shpëtim Allmuça (Qafleshi) | 49. Etleva Mustafa Persch (Hoxha) |
| 22. Nezihat Hamdi Sudi | 50. Ermalt Qemal Lamaj |
| 23. Lida Llazar Metushi | 51. Alma Kol Finis (Gojani) |
| 24. Luljeta Halil Strati (Canaj) | 52. Astrit Demir Zyko |
| 25. Ivanka Aleksandër Strati | 53. Ariana Dhimitër Rieger (Gjoni) |
| 26. Agron Rehi Alikaj | 54. Selim Ramiz Bici |
| 27. Raimonda Petrit Alikaj (Gjebrea) | 55. Eli Jozef Maleçek |
| 28. Eneida Agron Alikaj | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4288, datë 29.7.2004

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare",

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--------------------------|--|
| 1. Rifat Shaban Jashari | 10. Ylfete Ejup Jashari (Veliqi) |
| 2. Murat Rifat Jashari | 11. Shehrije Zena Jashari (Rexhepi) |
| 3. Bekim Hamzë Jashari | 12. Arbëroza Xhafer Jashari (Xhinofci) |
| 4. Lulzim Adem Jashari | 13. Feride Bekim Jashari |
| 5. Bashkim Rifat Jashari | 14. Shaban Murat Jashari |
| 6. Shqipe Adem Jashari | 15. Adem Lulzim Jashari |
| 7. Besarta Hamza Jashari | 16. Hamzë Bekim Jashari |
| 8. Fazli Rifat Jashari | 17. Zahide Murat Jashari |
| 9. Marigona Adem Jashari | 18. Besim Bekim Jashari |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.496, datë 23.7.2004

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË KROACISË, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E MBROJTJES SË MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Kroacisë, për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E MBROJTJES SË MJEDISIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË
KROACISË

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë,
më poshtë të quajtura “Nënshkruesit”,
duke u nisur nga interesi i përbashkët për të ruajtur mjedisin,
të ndërgjegjshëm për nevojat e përmirësimit të zbatimit të objekteve të mbrojtjes së mjedisit,
duke menduar se bashkëpunimi dypalësh për reduktimin e ndotjes së mjedisit është një
kontribut për zhvillimin e qëndrueshëm,
duke dëshiruar të forcojnë bashkëpunimin reciprok në fushën e mbrojtjes së mjedisit,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Nënshkruesit do të zhvillojnë bashkëpunimin reciprok në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, siç përcaktohet në legjislacionin e brendshëm të të dy shteteve.

Nënshkruesit do të zhvillojnë më tej bashkëpunimin dypalësh, si dhe do të nxisin institucione individuale, organizata dhe kompani për të zbatuar objektivat e këtij memorandumi.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së mjedisit do të jenë si më poshtë:

- vlerësimi i ndikimit në mjedis;
- menaxhimi i integruar i zonës bregdetare;
- edukimi dhe trajnimi për zhvillimin e sistemeve të mbrojtjes së mjedisit për përmirësimin dhe nxitjen e mbrojtjes së mjedisit;
- bashkëpunimin në fushën e legjislacionit të brendshëm mjedisor për përafrimin me legjislacionin e BE-së;
- projektet mjedisore.

Bashkëpunimi është i mundshëm edhe në fusha të tjera të mbrojtjes së mjedisit për të cilat do të bihet dakord ndërmjet Nënshkruesve dhe do të përcaktohet në një aneks të memorandumit, i cili do të jetë pjesë përbërëse e tij.

Neni 3

Bashkëpunimi i parashikuar në nenin 2 të memorandumit do të realizohet përmes:

- shkëmbimit të informacionit të ekspertëve për standardet mjedisore dhe çështje të tjera në fushën e bashkëpunimit;
- shkëmbimit të informacionit për legjislacionin mjedisor;
- shkëmbimit të vizitave të delegacioneve të ekspertëve dhe shkëmbimit të ekspertëve shumë të kualifikuar për fusha të veçanta bashkëpunimi;
- organizimit të takimeve, seminareve, leksioneve dhe *work-shope-ve* për ekspertët;
- hartimit të projekteve të përbashkëta dypalëshe në fushën e bashkëpunimit;
- formave të tjera të mundshme bashkëpunimi për zbatimin e objektivave të këtij memorandumi.

Neni 4

Nënshkruesit do të zhvillojnë programe katërvjeçare pune që do të përmbajnë detyra specifike për zbatimin e bashkëpunimit dypalësh sipas nenit 2 të këtij memorandumi.

Nënshkruesit do të bashkërendojnë zbatimin e bashkëpunimit dypalësh në fushat e mbuluara nga programi i punës, dhe autoritetet përgjegjëse të nënshkruesve do të përcaktojnë dhe do të zhvillojnë forma të veçanta individuale bashkëpunimi dhe do të përcaktojnë përkatësisht funksionarët që do të ndjekin zbatimin e këtij memorandumit.

Neni 5

Sipas dispozitave të nenit 3 dhe 4, dhe nëse nuk bihet dakord ndryshe, kryerja e detyrave të programit të përbashkët të punës do të jetë detyrë e secilit nënshkrues, duke marrë parasysh fondet në dispozicion. Përsa i përket vizitave të ekspertëve dhe delegacioneve sipas nenit 3 të memorandumit, shpenzimet për akomodimin, dietat dhe punën e tyre do të merren përsipër nga palët dërguese.

Neni 6

Në Republikën e Shqipërisë, bashkërendimi dhe zbatimi i aktiviteteve në këtë memorandum do të ndiqet nga Ministria e Mjedisit dhe në Republikën e Kroacisë, nga Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit, Planifikimit të Territorit dhe Ndërtimit.

Neni 7

Nënshkruesit bien dakord që, për të zbatuar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit sipas këtij memorandumit, ata nuk do të ndërmarrin apo fillojnë asnjë aktivitet që do të dëmtonte potencialisht nënshkruesin tjetër.

Neni 8

Çdo çështje në fushën e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së mjedisit e papërfshirë në këtë memorandum do të zgjidhet me konsultim dhe negociata ndërmjet Nënshkruesve.

Neni 9

Depozitat e këtij memorandumit mund të amendohen vetëm me marrëveshje të ndërsjellë midis Nënshkruesve.

Neni 10

Ky memorandum përfundohet për një periudhë të papërcaktuar kohe.

Memorandumi mund të denoncohet nga secili Nënshkrues me anë të një njoftimi me shkrim që i dërgohet nënshkruesit tjetër përmes kanaleve diplomatike. Në këtë rast, vlefshmëria e memorandumit përfundon gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit me shkrim për dëshirën e denoncimit të memorandumit.

Neni 11

Ky memorandum do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit nga secili Nënshkrues me anë të të cilit nënshkruesit njoftojnë reciprokisht njëri-tjetrin, me anë të kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave që kërkon legjislacioni i secilës palë për hyrjen në fuqi të memorandumit.

Bërë në Zagreb në 17 qershor 2004 në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, kroate dhe angleze, të treja tekstet janë autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, versioni në anglisht do të merret për bazë.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ministri i Mjedisit
Et'hem Ruka

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
KROACISË

Ministri i Mbrojtjes së Mjedisit, Planifikimit të
Territorit dhe Ndërtimit
Marina Matulovic Dropulic

UDHËZIM
Nr.4, datë 11.8.2004

PER MËNYRËN E USHTRIMIT TË KOMPETENCËS PËR PLANIFIKIMIN E
TERRITORIT NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës, në nenin 12 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar dhe me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore",

nisur nga praktika e deritanishme dhe ndryshimet që solli ligji nr.8991, datë 23.1.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar",

duke pasur parasysh se:

1. Në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 10, përcaktohet se planifikimi urban është funksion i vetë komunës apo bashkisë, ku në pikën 3/1 germa g thuhet: "...planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi sipas mënyrës së përcaktuar në ligj". Pra planifikimi urban, si funksion i vetë njësisë së qeverisjes vendore, ushtrohet nga bashkia apo komuna, por gjithnjë sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. Ligji që përcakton mënyrën e planifikimit urban në Republikën e Shqipërisë, është ligji nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i cili përcakton rregullat, procedurën dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencës në fushën e planifikimit territorial.

Në kuadër të decentralizimit për ushtrimin e kompetencës dhe të funksionit të planifikimit territorial nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, ligji nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" u ndryshua me ligjin nr.8991, datë 23.1.2003.

3. Në rastet kur bashkia ose komuna, në pamundësi të ngritjes së strukturës tip të njësisë së urbanistikës, si rrjedhojë e këshillit teknik e më pas edhe e KRRT-së, kompetencën e planifikimit të territorit e delegon në qark, bazuar në nenin 13 pika 2 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ku thuhet: "Qarku ushtron të gjitha funksionet që i delegohen nga një ose më shumë komuna apo bashki, brenda territorit të tij, sipas një marrëveshjeje të lidhur midis tyre".

Në pamundësi të ngritjes së formacionit të KRRT-së, sipas nenit 17 pika 2, për mungesë në strukturën organizative të saj dhe specialistësh të fushave përkatëse, kompetenca e planifikimit territorial delegohet në qark.

4. Ushtrimi i vendimmarrjes nga KRRT-të në bashki/komunë bëhet në përputhje me nenin 20 pika 2 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar".

a) Për germat "a", "b", "c", "ç" dhe "d" të pikës 2 të nenit 20 të këtij ligji, shqyrtimi dhe miratimi nga KRRT-të e bashkisë/komunës nuk është përfundimtar, pasi për një rakordim me planet rajonale, masterplanet dhe me planet e zhvillimit rajonal, si dhe në përputhje me germat "a", "b", "ç" dhe "d" të pikës 1 të nenit 20, miratimi përfundimtar bëhet nga KRRT-të e qarkut.

b) Për germat "a", "c", "ç" dhe "dh" të pikës 1 të nenit 20, shqyrtimi dhe miratimi nga KRRT-të e qarkut nuk është përfundimtar, pasi për një rakordim me politikat kombëtare dhe qeveritare, si dhe në përputhje me nenin 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", miratimi përfundimtar bëhet nga KRRTSH-ja.

c) Germa "e" e pikës 2 të nenit 20 përcakton kompetencën e KRRT-së së bashkisë apo komunës, për shqyrtimin dhe miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit, brenda vijës kufizuese të ndërtimit (vija e verdhë) të qytetit apo të fshatit.

ç) Germa "dh" e pikës 1 të nenit 20 përcakton kompetencën e KRRT-së së qarkut, për shqyrtimin dhe miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit jashtë vijës kufizuese të ndërtimit (vijës së verdhë) të qytetit apo të fshatit, në zbatim dhe zbatim të masterplaneve.

5. Në nenin 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", përcaktohet se KRRTSH-ja miraton studimet rajonale dhe pjesore të zonave turistike, pra të gjitha zhvillimet ndërtimore sipas procedurës së përcaktuar në nenin 70.

Për sa më lart, me qëllim saktësimin e vendimmarrjes së KRRT-ve të çdo niveli në fushën e planifikimit të territorit,

UDHËZOJ:

1. Në njësinë e qeverisjes vendore, ngritja e KRRT-ve të bëhet në përputhje me përcaktimet e neneve 17, 18, 24 dhe 25 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar.

2. Për ngritjen dhe funksionimin e KRRT-ve, komuna ose bashkia jo e kategorisë së parë:

a) duhet të ngrejë strukturën tip të njësisë së urbanistikës së saj, sipas përcaktimit të bërë në nenin 24 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar";

b) duhet të sigurojë funksionimin e strukturave të administratës, përfaqësuesit e të cilëve janë anëtarë të KRRT-së, sipas përcaktimit të bërë në nenin 17 pika 2 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003;

c) duhet të sigurojë me specialistë të fushave përkatëse dhe të zgjedhur, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 17 pika 2 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003;

ç) duhet të ngrejë dhe të miratojë, me vendim të këshillit komunal apo bashkiak, këshillin teknik, sipas përcaktimit të bërë në nenin 25 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003.

3. Çdo komunë apo bashki që nuk realizon kërkesat e pikës 2 të këtij udhëzimi, duhet t'ia delegojë kompetencën e planifikimit të territorit, këshillit të qarkut përkatës, me miratim të këshillit komunal apo bashkiak.

Delegimi i kësaj kompetence të bëhet në përputhje me nenin 13 pika 2 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Marrëveshja e bashkëpunimit nënshkruhet nga kryetari i komunës apo bashkisë dhe kryetari i këshillit të qarkut.

4. Në marrëveshjen e bashkëpunimit duhet të saktësohet:

a) Kryetari i komunës apo bashkisë që delegon kompetencën, të jetë i pranishëm në KRRT-në e qarkut, si përfaqësues i bashkisë apo komunës, kur ajo merr në shqyrtim çështje brenda territorit të komunës apo bashkisë, që ka deleguar kompetencën e planifikimit të territorit. Në këtë rast, ai merr pjesë në votim me cilësinë e anëtarit të KRRT-së.

b) Kërkesat për shesh dhe leje ndërtimi të depozitohen në njësinë e urbanistikës së komunës apo të bashkisë që ka deleguar kompetencën e planifikimit të territorit.

c) Të ardhurat që rrjedhin nga neni 51 i ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar, mbledhen nga qarku dhe disponohen vetëm për financimin e studimeve urbanistike, të kërkuara nga bashkia apo komuna që ka deleguar kompetencën e planifikimit të territorit.

ç) Të ardhurat që rrjedhin nga neni 16 i ligjit nr.8992, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore", kalojnë në llogarinë e bashkisë apo komunës që ka deleguar kompetencën dhe administrohen nga këshilli i bashkisë apo komunës.

Kjo e ardhur përdoret me destinacion për ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës publike për zonën e studiuar, brenda të cilës miratohet ngritja e strukturës ndërtimore.

d) Marrëveshja e bashkëpunimit ka vlefshmëri deri në përfundimin e mandatit të këshillit bashkiak apo komunal, me të drejtë rinovimi kur nuk përmbushen kërkesat e pikës 2 të këtij udhëzimi.

5. Të ardhurat e përcaktuara në pikën 3 germa "c" dhe "ç" të këtij udhëzimi, nuk mund të përdoren jashtë destinacionit të përcaktuar në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" dhe në ligjin nr.8992, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore".

6. KRRT-ja e komunës apo e bashkisë, e ngritur në përputhje me pikën 2 të këtij udhëzimi, ushtron kompetencën e planifikimit të territorit, në përputhje me nenin 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003.

a) Për çdo studim urbanistik, sipas përcaktimit në germa "a", "b", "c", "ç" dhe "d" pika 2 të nenit 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003, të miratuar nga KRRT-ja e komunës apo bashkisë, duhet të bëhet shqyrtimi dhe miratimi në KRRT-në e qarkut.

b) Për çdo studim urbanistik të përcaktuar në gerrat "a", "c", "ç" dhe "dh" pika 1 të nenit 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003, të miratuar nga KRRT-ja e qarkut, sipas rastit, në përputhje me nenin 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", duhet bërë miratimi në KRRTRSH.

7. KRRT-ja e komunës apo bashkisë, shqyrton dhe miraton vetëm sheshet dhe lejet e ndërtimit brenda vijës kufizuese të ndërtimit (vijës së verdhë) të qytetit apo të fshatit, sipas përcaktimit të bërë në germen "e" të pikës 2 të nenit 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003.

Vija kufizuese e ndërtimit (vija e verdhë) e qytetit ose e fshatit nuk është kufiri administrativ i komunës apo bashkisë.

8. Jashtë vijës kufizuese të ndërtimit (vija e verdhë) të qytetit ose të fshatit, nuk mund të shqyrtohet dhe miratohet shesh dhe leje ndërtimi, pa pasur studime rajonale ose masterplane të miratuara.

KRRT-ja e qarkut shqyrton dhe miraton shesh dhe leje ndërtimi, konform studimeve të miratuara, jashtë vijës kufizuese të ndërtimit (vija e verdhë) të qytetit ose të fshatit, sipas përcaktimit të bërë në germen "dh" të pikës 1 të nenit 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003.

9. Kur sipërfaqja e sheshit të ndërtimit jashtë vijave kufizuese të ndërtimit (vija e verdhë) të qytetit ose të fshatit, është mbi 0,5 ha, shqyrtimi dhe miratimi i sheshit të ndërtimit konform studimeve urbanistike, është kompetencë e KRRTRSH-së, sipas përcaktimit të bërë në nenin 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën".

Në këtë rast, pas miratimit të sheshit të ndërtimit në KRRTRSH, leja e ndërtimit jepet nga KRRT-ja e qarkut përkatës.

10. Në zonat turistike veprohet si vijon:

Zonat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.88, datë 1.3.1993 "Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit", konsiderohen zona turistike.

a) KRRT-ja e komunës ose e bashkisë, brenda kufirit administrativ të së cilës përfshihet zona turistike, nuk ka kompetencë vendimmarrjeje të planifikimit të territorit në territorin e zonës turistike, që ndodhet jashtë vijës kufizuese të ndërtimit (vijë e verdhë) të qytetit ose fshatit.

Kjo është përcaktuar edhe në paragrafin e dytë të pikës 2 të nenit 20 të ligjit nr.8991, datë 21.3.2003.

b) Miratimi i studimeve urbanistike në zonat turistike bëhet nga KRRTRSH. Materiali plotësohet dhe paraqitet në KRRT-ja e qarkut përkatës, i cili ia përcjell më pas KRRTRSH-së.

c) Kërkesa për shesh dhe leje ndërtimi, në zonat turistike sipas gremës "a" të kësaj pike, depozitohen në sekretarinë teknike të KRRT-së së qarkut përkatës. Sheshi i miratuar nga KRRT-ja e qarkut shqyrtohet në Këshillin e Zhvillimit të Turizmit (KZHT). KRRT-ja e qarkut, mbi bazën e vendimit të KZHT-së, miraton lejen e ndërtimit.

ç) Kur sheshi i ndërtimit brenda zonës turistike është mbi 0.5 ha, miratimi i tij bëhet në KRRTRSH.

11. Ligji nr.8991, datë 23.1.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", ndryshuar me vendimin nr.2, datë 25.1.1999 të Gjykatës Kushtetuese dhe me ligjet nr.8453, datë 4.2.1999, nr.8501, datë 16.6.1999 dhe nr.8682, datë 7.11.2000" është botuar në Fletoren Zyrtare nr.5, faqe 152 të vitit 2003.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.88, datë 1.3.1993 "Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit" është botuar në Fletoren Zyrtare nr.4 të vitit 1993.

12. Udhëzimi nr.3, datë 30.1.2002 "Mbi mënyrën ligjore që duhet ndjekur për planifikimin urban dhe dhënie e shesheve dhe lejeve të ndërtimit në bashki/komuna", është revokuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr.8991, datë 23.1.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TURIZMIT
Bashkim Fino

UDHËZIM
Nr.7/1, datë 3.8.2004

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 10.2.2004 "PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR"**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr.7, datë 10.2.2004 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", pika 16 "Ambalazhet qarkulluese" ndryshohet si më poshtë:

16. "Ambalazhet"

Ambalazhet mund të jenë qarkulluese dhe të pakthyeshme. Në funksion të këtij dallimi ndryshon edhe mënyra e aplikimit të TVSH-së.

16.1 Ambalazhet qarkulluese

Janë ambalazhe të natyrës si kontenier, qelqe, arka, etj. Ambalazhet qarkulluese si rregull furnizohen së bashku dhe në të njëjtën kohë me mallrat që ata përmbajnë.

Këto llojë ambalazhesh jepen nga shitësi (furnitori), së bashku me mallin në to në drejtim të blerësit (klientit); ato ruhen provizorisht nga blerësi dhe më pas kthehen nga ky i fundit përsëri në drejtim të shitësit.

Blerja e ambalazheve nga shitësit i jep atij të drejtën e kreditimit të TVSH-së sipas rregullave të parashikuara në nenin 33 të ligjit për TVSH-në.

Ambalazhet që i jepen blerësit nga shitësi (më saktë vlera e tyre), nuk përfshihen në vlerën e tatueshme të mallrave që ato shoqërojnë gjatë furnizimit.

Ambalazhet që i janë dhënë blerësit, duhet të kthehen te shitësi brenda një afati normal sipas fushës së aktivitetit të cilit ato i takojnë. Ky afat varion edhe sipas natyrës së produktit që ambalazhet, përmbajnë dhe duhet paraqitur në kontratën e lidhur mes palëve.

Si kushte për mospërfshirjen e vlerës së ambalazheve në vlerën e tatueshme të mallrave që ato përmbajnë duhet që:

- Së pari, ato nuk duhet të jenë faturuar nga shitësi;
- Së dyti, duhet të ekzistojë një kontratë e lidhur midis palëve për dhënien dhe kthimin e ambalazheve. Njëkohësisht, në kontratë duhet të paraqitet edhe afati i kthimit të ambalazheve nga blerësi te shitësi.

Ambalazhet që blerësi nuk i kthen te shitësi konsiderohen sikur të ishin shitur dhe i nënshtrohen TVSH-së mbi vlerën e tyre.

16.2 Ambalazhet e pakthyeshme

Janë ambalazhe të natyrës, si: kartona, shishe plastike, qese plastike etj.

Vlera e këtyre ambalazheve është element i vlerës së tatueshme të mallrave që ato përmbajnë.

Blerja e ambalazheve nga shitësi i jep atij të drejtën e kreditimit të TVSH-së sipas rregullave të parashikuara në nenin 33 të ligjit për TVSH-në.

Mbi vlerën e tatueshme të mallrave që përfshin edhe vlerën e ambalazheve, zbatohet TVSH-ja në shitje.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

UDHËZIM
Nr.8, datë 28.7.2004

PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE PËR TË LUFTUAR
FINANCIMIN E TERRORIZMIT NË SISTEMIN E TATIM-TAKSAVE

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Ky udhëzim është hartuar në mbështetje të neneve 5, 6, 7, 8, 10/1 dhe 12 të ligjit nr. 8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar me ligjin nr.9084, datë 6.19.2003.

2. Ky udhëzim do të japë parimet e përgjithshme për shkëmbimin e informacionit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftës kundër Financimit të Terrorizmit (autoriteti përgjegjës).

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e mëposhtme do të kenë këto kuptime:

1. Pastrim parash–Qarkullimi dhe riciklimi i parave që burojnë nga vepra penale, sikurse dhe ndryshimi, transmetimi, transformimi dhe tjetërsimi i produkteve dhe pasurive të siguruar nga veprat penale që synon fshehjen e burimit ose të origjinës së paligjshme, (sipas paraqitjes në nenin 2 të ligjit).

2. Financimi i terrorizmit–Financimi i akteve terroriste dhe/ose i organizatave terroriste.

3. Transaksione të dyshimta–Çdo transaksion (pavarësisht sasisë), që nga natyra ose karakteri është i pazakonshëm për aktivitetin e personit, ose që për ndonjë arsye tjetër ngre dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

4. Tatimpagues–"Klienti" i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është një person fizik (biznes ose jo), person juridik ose përfaqësues ligjor, rezident ose jo në Shqipëri, i huaj ose shqiptar, privat ose publik, të cilit i kërkohet të paguajë tatime, të mbajë informacion ose të japë informacion për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

5. Autoriteti përgjegjës–Drejtori i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave. Brenda (autoritetit përgjegjës) ndodhet Njësia e Inteligjencës Financiare (NIF) që është një agjenci kombëtare qendrore përgjegjëse për të kërkuar, marrë, analizuar dhe shpërndarë dokumentet dhe informacionin, sipas ligjit, në mënyrë që të luftojë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

6. Para–Për qëllime të këtij udhëzimi, "para" përfshin çdo lloj valute në qarkullim duke përfshirë kartëmonedha dhe monedha vendase dhe/ose të huaja.

7. Vepër penale–Sipas këtij udhëzimi, do të thotë veprim ose mosveprim, shoqërisht i rrezikshëm, i kryer me faj dhe i parashikuar nga ligji penal shqiptar ose i një vendi të huaj.

8. Të ardhura të paligjshme–Fonde monetare, pasuri të tjera ose të drejta të tjera pasurish, të zotëruara nga një person që janë fituar përmes kryerjes së një ose disa veprave penale.

Neni 3

Identifikimi i "tatimpaguesve"

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të mbajë informacionin e mëposhtëm lidhur me tatimpaguesit:

a) Persona fizikë jofitimprurës (individë)–Informacionin më të freskët lidhur me emrin e tatimpaguesit, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, adresën e përkohshme dhe të përhershme të banimit, llojin dhe numrin e dokumentit zyrtar të identifikimit dhe institucionin që e ka lëshuar.

b) Personat fizikë fitimprurës–Informacionin më të freskët lidhur me emrin e tatimpaguesit, mbiemrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës që lejon personin të kryejë aktivitet fitimprurës, numrin e identifikimit të tatimpaguesit, datën e lëshimit të lejes nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ushtrimin e aktivitetit fitimprurës të personit.

c) Person juridik–Informacioni më i freskët lidhur me emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, datën e vendimit të gjykatës lidhur me regjistrimin si person juridik, numrin e identifikimit të taksave, datën e autorizimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për të ushtruar aktivitetin fitimprurës, adresën e përkohshme dhe të përhershme të zyrës qendrore, natyrën dhe llojin e aktivitetit.

d) Përfaqësuesi ligjor–Informacioni më i freskët lidhur me emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, datën dhe vendin e lindjes, numrin e dokumentit zyrtar të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të klientit (ëve) dhe institucionin që e ka lëshuar atë, vërtetim për autorizimin e dhënë përfaqësuesit që të veprojë në emër të klientit.

Neni 4

Raportimi i aktivitetit të dyshimtë

1. Punonjësi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duhet të ekzaminojë aktivitetet e mëposhtme dhe të përpiket të zbulojë transaksione të dyshimta të pastrimit të parave dhe/ose të financimit të terrorizmit në çdo aktivitet dhe kryesisht në:

- a) negociatat për borxhet, kreditë ose garancitë e dhëna nga borxhmarrësi;
- b) transaksionet e lidhura me llogaritë bankare;
- c) transaksionet që lidhen me pagesat, transferimet e borxhit dhe çeqet;
- d) pagesat e ligjshme valutore;
- e) blerjen, shitjen, transfertën etj. e stokut, të bondeve, pasurive dhe borxheve;
- f) administrimin e fondeve të investimit;
- g) aktivitetet e kompanive të sigurimeve, duke përfshirë risigurimet;
- h) fatura të përgatitura nga blerësit;
- i) kuponat dhe certifikatat e taksave.

2. Nëse zbulohet një transaksion i dyshimtë lidhur me aktivitetet e mësipërme, atëherë duhet dërguar një raport tek autoriteti përgjegjës për “transaksionin e dyshimtë” (sipas shtojcave në anekset II dhe III për formularin dhe instruksionet bashkëlidhur, të cilat janë pjesë e këtij udhëzimi).

3. Raporti për transaksionin e dyshimtë duhet t’i dorëzohet autoritetit përgjegjës menjëherë, por jo më vonë se 72 orë pas zbulimit.

4. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas kërkesave të ligjit, ndalohen që të njoftojnë personat e përfshirë në një transaksion të dyshimtë për faktin se është dërguar një raport për transaksion të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës, apo që ky i fundit ka kërkuar informacion rreth veprimtarisë së tyre.

5. Raportimi i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve bëhet sipas formularit bashkëlidhur, në ankesin II, shtojca ”Raporti i aktivitetit të dyshimtë”, që është pjesë e këtij udhëzimi.

Neni 5

Njësia qendrore

1. Me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit sipas këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të ngrëjë një njësi qendrore që do të jetë përgjegjëse për identifikimin dhe mbledhjen e transaksioneve të dyshimta.

2. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do të caktojë një person me pozitë drejtuese për të drejtuar këtë njësi.

3. Kreu i njësisë:

a) do të caktojë një person në zyrën qendrore dhe në çdo degë, që të shërbejë si person kontakti për autoritetin përgjegjës;

b) do të organizojë procesin e monitorimit dhe do të sigurojë kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit;

c) do të analizojë çdo transaksion që është identifikuar si i dyshimtë dhe do të përcaktojë nëse ai/ajo beson se është i dyshimtë sipas ligjit dhe këtij udhëzimi;

d) nëse informacioni është përcaktuar si i dyshimtë, kreu i njësisë do t'ia nisë informacionin autoritetit përgjegjës pas autorizimit të dhënë nga Drejtori ose zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;

e) do të konsultohet me punonjës të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për rrugët për identifikimin e transaksioneve të dyshimta;

f) do të organizojë trajnim special për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që të sigurojë se punonjësit:

i) janë të vetëdijshëm për ligjet dhe politikat që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

ii) kanë shprehitë e nevojshme për të kontrolluar transaksionet për të zbuluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

iii) janë të vetëdijshëm për kërkesat për raportim dhe sesi përgatitet një raport;

g) do të përgatisë raport me shkrim të paktën një herë në vit për procesin e monitorimit (duke përfshirë numrin e raporteve të dyshimta të identifikuara) dhe do t'ia dorëzojnë atë drejtorit të taksave;

h) do të monitorojë tatimpaguesit dhe transaksionet e referuara tek autoriteti përgjegjës dhe do t'ia komunikojë këtë dy herë në vit, përmes drejtorit të tatimeve, autoritetit përgjegjës.

4. Drejtuesit dhe punonjësve të njësisë qendrore duhet t'u jepet autoritet për të marrë çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur funksionet e tyre. Atyre do t'u kërkohet që të mbajnë konfidenciale natyrën e aktiviteteve të tyre.

5. Drejtuesi i njësisë qendrore do të raportojë vetëm te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

6. Në rastet kur drejtuesi i njësisë qendrore mendon se ndonjë nga punonjësit nuk po merr pjesë në procesin e monitorimit, ai duhet të njoftojë menjëherë Drejtorin ose zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve.

Neni 6

Shkëmbimi i informacionit

Kur informacioni shihet i izoluar, mund të jetë i pakuptimtë, por kur kombinohet me të dhëna të tjera që gjenden në një bazë të vetme të dhënash, mund të çojë në identifikimin e pastruesve të parave apo të financuesve të terrorizmit. Kështu që, për të krijuar një bazë elektronike të dhënash me informacion historik, autoriteti përgjegjës, përmes personave të kontaktit, do të dërgojë kërkesë për informacion te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Personat e kontaktit do të bien dakord për kohën e përgjigjes sipas afateve të parashikuara në ligj. Nëse ka ndonjë mosmarrëveshje lidhur me afatin e përgjigjes, atëherë çështja zgjidhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Ministri i Financave.

Neni 7

Raportimi i aktivitetit të dyshimtë

1. Kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përmes investigimit administrativ, civil apo penal, beson se është duke u kryer ose po kryhet krimi i pastrimit të parave ose financim terrorizmi, ai njofton me shkrim menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë autoritetin përgjegjës.

2. Pas marrjes së letrës nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve lidhur me persona, njësi ligjore apo përfaqësues ligjorë ose transaksione të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, autoriteti përgjegjës do të kryejë menjëherë një kontroll të regjistrave zyrtarë dhe do t'i përgjigjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 15 ditë. Sidoqoftë, kur është nevojë urgjente për informacion, kërkesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mund të bëhet verbalisht dhe të konfirmohet me anë të një letre brenda tri ditëve pune dhe drejtori i autoritetit përgjegjës ose përfaqësuesi i tij do të përgjigjet sa më shpejt të jetë e mundur.

3. Kërkesat e bëra nga autoriteti përgjegjës Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me individë, biznese, persona juridikë, përfaqësues ligjorë dhe transaksione, do të bëhen me anë të një letre që përmban informacion të mjaftueshëm për t'i dhënë mundësi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që të bëjë kontrollin në regjistrat zyrtarë.

4. Sidoqoftë, kur ka arsye të bazuar për pastrim parash ose financim terrorizmi, dhe besohet se ka nevojë urgjente për informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, personi i kontaktit të autoritetit përgjegjës i bën një kërkesë verbale personit të kontaktit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kërkesa të tilla duhet të dokumentohen brenda tri ditëve me anë të një letre me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

5. Informacioni i kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do t'i jepet autoritetit përgjegjës jo më vonë se 15 ditë nga marrja e kërkesës; ky afat mund të ndryshojë vetëm kur për arsye të forta palët bien dakord me shkrim ta shtyjë ose ta afrojnë afatin. Çdo zgjatje nuk mund të jetë më tepër se 8 ditë.

6. Kur autoriteti përgjegjës ka bllokuar ose përgatitet të bllokojë një transaksion për 72 orë dhe kërkon informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ky informacion duhet t'i vihet në dispozicion brenda 48 orësh. Kjo kërkesë mund të bëhet me shkrim ose me gojë. Çdo kërkesë me gojë do të dokumentohet me shkrim brenda tri ditësh pune.

7. Kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka arsye të mjaftueshme të besojë se ka ndodhur pastrim parash ose financim terrorizmi që përfshin një vend të huaj, ai mund t'i kërkojë autoritetit përgjegjës që të bëjë kërkesë për informacion vendit të huaj. Kërkesa duhet bërë me shkrim ose në rastet urgjente me telefon (në rast se juridiksioni i huaj pranon). Kërkesa të tilla, duhet të kenë informacion të mjaftueshëm dhe detaje të tjera lidhur me persona, përfaqësues ligjorë ose transaksione që do të lejonin kontrollin e regjistrave në një juridiksion të huaj. Nëse kërkesa është bërë telefonikisht, ajo do të dokumentohet brenda tri ditësh pune.

8. Përdorimi i informacionit të marrë nga juridiksione të huaja do të kontrollohet nga të gjitha kufizimet e vendosura nga furnizuesi i informacionit.

9. Kur NIF, në një juridiksion të huaj, kërkon informacion i cili sipas autoritetit përgjegjës përfshin informacion nga tatimet, autoriteti përgjegjës do t'ia kërkojë këtë informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkrim ose në rast urgjence me telefon. Kur kërkesa bëhet me telefon, ajo do të dokumentohet me shkrim brenda tri ditësh pune.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të përgjigjet sipas parashikimeve në paragrafin 5 të këtij neni.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të japë të gjithë informacionin që disponon, të cilin është e lejuar ta ndajë me juridiksione të huaja. Nëse ligji shqiptar e kufizon komunikimin e një pjese të informacionit (neni 15 i ligjit), atëherë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të identifikojë qartësisht këtë informacion në përgjigjen e vet (me shkrim ose me telefon) tek autoriteti përgjegjës.

Neni 8

Përgjegjësitë e punonjësit

1. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha dokumenteve, të dhënave dhe të informacionit të marrë nga autoriteti përgjegjës; çdo nxjerrje e paautorizuar e këtij informacioni e bën punonjësin subjekt të përgjegjësisë penale dhe administrative.

2. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që i japin informacion konfidencial autoritetit përgjegjës sipas kërkesave të ligjit janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale ose administrative.

3. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për raste të shkeljeve dhe mos zbatimit të ligjit dhe të këtij udhëzimi, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, kanë përgjegjësi administrative dhe ndëshkohen me gjobë nga autoriteti përgjegjës sipas parashikimeve në nenin 14 të ligjit.

Neni 9

Detyrimi për të mbajtur informacionin dhe dokumentet për transaksionet e dyshimta

1. Dokumentet ose informacioni që lidhet me transaksionet e dyshimta duhet të mbahet për të paktën pesë vjet nga data e zbulimit të transaksionit.

2. Dokumentet duhet të mbahen në original dhe të ruhen në mënyrë të tillë që të dhënat të reflektojnë tërësisht transaksionin e kryer dhe palët e përfshira në të. Nëse ka vend, dokumentet duhet të mbahen në formë të tillë që të mund të përdoren si evidencë gjatë procedurave gjyqësore (për shembull të firmosura, të vulosura të noterizuara dhe të certifikuara).

3. Ruajtësi i dokumentit duhet të identifikohet dhe dokumenti duhet të tregojë qartë personin dhe datën e certifikimit. Dokumentet duhet të sistemohen, të ruhen dhe të mbahen në mënyrë të tillë që mund të gjenden dhe të nxirren shpejt në rastet kur ato nevojiten.

4. Kur është mundësia, informacioni do të sistemohet dhe mbahet edhe në formë elektronike.

Neni 10

Data e hyrjes në fuqi

Kjo udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Arben Malaj

RELACION SHOQËRUES

PËR UDHËZIMIN “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTËN KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT, NË SISTEMIN E TATIM-TAKSAVE”

Në zbatim të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar me ligjin nr.9084, datë 19.6.2003, neneve 5, 6, 7, 8, 10/1 dhe 12, është përgatitur udhëzimi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e zbatimit të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit, si dhe të qartësojë procedurat e raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve te Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (e cila shërben si qendër kombëtare për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e zbulimit të informacionit financiar autoriteteve të zbatimit të ligjit, lidhur me pastrim parash dhe financim potencial të terrorizmit).

Përmirësimet në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave të bëra me ligjin nr.9084, datë 19.6.2003, në nenin 10/1 specifikojnë detyrimet e organeve tatimore në raport me DPPP-në (autoritetin përgjegjës), si dhe kërkojnë që format dhe procedurat e identifikimit dhe të raportimit të përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Në dallim me kërkesat e ligjit, të mëparshëm, organet tatimore shpëputen si subjekte të ligjit dhe marrin detyrime më vete lidhur me identifikimin e personave fizikë e juridikë të tyre, sipas

procedurave të parashikuara në pikën 2 të nenit 4 të ligjit dhe i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave ose financim të terrorizmit.

Ndryshe nga subjektet e tjera të ligjit, organet tatimore do të raportojnë për çdo dyshim që konstaton gjatë veprimtarisë së tyre me personat fizikë ose juridikë, dhe jo për transaksionet mbi vlerat e përcaktuara në ligj. Ato do të raportojnë për çdo dyshim sipas formës së “Raportit të aktivitetit të dyshimtë” (RAD) në ankesin II të udhëzimit, i përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave bashkëlidhur dhe pjesë e udhëzimit.

Organet tatimore janë të ngarkuar nga ligji me detyrën për ngritjen e një njësie në qendër dhe caktimin e personave të kontaktit në degë dhe agjenci, të cilët do të sigurojnë një shkëmbim të shpejtë të informacionit lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit.

Udhëzimi jep parimet e përgjithshme për shkëmbimin e informacionit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit (autoriteti përgjegjës).

Udhëzimi përkufizon termet kryesore, si: “transaksione të dyshimta”, tatimpagues që për efekt të ligjit konsiderohen si “klient”, “autoritet përgjegjës”, “vepër penale”, “të ardhura të paligjshme” etj.

Ai paraqet detyrimet e organeve tatimore për identifikimin e tatimpaguesve, mbledhjen, ruajtjen dhe dërgimin tek autoriteti përgjegjës të informacionit mënyrën e raportimit të aktiviteteve të dyshimta.

Detyrimi për identifikimin e tatimpaguesve është kërkesë dhe e legjislacionit tatimor në Republikën e Shqipërisë, por në këtë udhëzim janë të përmblodhura ato kërkesa që nevojiten për efekt të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave lidhur me personat fizikë fitimprurës ose jofitimprurës, personat juridikë, përfaqësuesit ligjorë të klientëve (tatimpaguesve).

Udhëzimi kërkon freskimin e informacionit lidhur me emrin e tatimpaguesit, mbiemrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës që lejon personin të kryejë aktivitetin ligjor, numrin e identifikimit të tatimpaguesit, datën e lëshimit të lejes.

Në udhëzim, veç specifikimeve të formës së raportimit, specifikohet gjithashtu dhe mënyra, koha e raportimit, ngritja e njësisë qendrore dhe përcaktimi i personave të kontaktit në njësi e degë të organeve tatimore në nivele vendore.

Përcaktohet gjithashtu që punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sipas kërkesave të ligjit ndalohen që të njoftojnë personat e përfshirë në një transaksion të dyshimtë ose t'i njoftojnë se është dërguar një raport për transaksion të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës, apo që ky i fundit ka kërkuar informacion rreth veprimtarisë së tyre.

Ngritja e njësisë qendrore bëhet me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit sipas ligjit, për identifikimin, mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta.

Në qendër caktohet një person me funksion dhe pozitë drejtuese për të drejtuar këtë njësi dhe rregulluar marrëdhëniet me autoritetin përgjegjës, si dhe një ndihmës dhe zëvendës të tij.

Kreu i njësisë cakton një person në zyrat qendrore, dhe në çdo degë, që të shërbejë si person kontakti për autoritetin përgjegjës. Ai do të organizojë procesin e monitorimit dhe do të sigurojë kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit. Analizon çdo transaksion që është identifikuar si i dyshimtë dhe përcakton nëse ai/ajo beson se është i dyshimtë sipas ligjit dhe sipas këtij udhëzimi. Nëse informacioni është përcaktuar si i dyshimtë, kreu i njësisë ia dërgon informacionin autoritetit përgjegjës pas autorizimit të dhënë nga Drejtori ose zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Ai do të konsultohet me punonjës të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për rrugët lidhur me identifikimin e transaksioneve të dyshimta.

Ai do të organizojë trajnim special për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që të sigurojë se punonjësit:

i) janë të vetëdijshëm për ligjet dhe politikat që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

ii) kanë shprehitë e nevojshme për të kontrolluar transaksionet për të zbuluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

iii) janë të vetëdijshëm për kërkesat për raportim dhe sesi përgatitet një raport.

Kreu i njësisë qendrore përgatit raporte me shkrim të paktën njëherë në vit për procesin e monitorimit (duke përfshirë numrin e raporteve të dyshimta të identifikuara) dhe t'ia dorëzojnë atë drejtorit të taksave.

Do të monitorojë tatimpaguesit dhe transaksionet e referuara tek autoriteti përgjegjës dhe t'ia komunikojë këtë dy herë në vit, përmes drejtorit të taksave, autoritetit përgjegjës.

Drejtuesit dhe punonjësve të njësisë qendrore duhet t'u jepet autoritet për të marrë çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur funksionet e tyre. Atyre u kërkohet që të mbajnë konfidenciale natyrën e aktiviteteve të tyre.

Drejtuesi i njësisë qendrore do të raportojë vetëm te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Në rastet kur drejtuesi i njësisë qendrore mendon se ndonjë nga punonjësit nuk po merr pjesë në procesin e monitorimit ai duhet të njoftojë menjëherë Drejtorin ose zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve.

Udhëzimi përcakton dhe procedurat e shkëmbimit të informacionit, mënyrën dhe afatet e raportimit të aktiviteteve të dyshimta që lidhen me pastrim parash apo implikime në financim terrorizmi, si dhe rastet kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kërkon informacion te Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, ose informacione që lidhen me shërbime homologe ose kanë nevojë për plotësim me informacion nga këto shërbime. Informacioni i marrë nga juridiksione të huaja do të kontrollohet nga të gjitha kufizimet e vendosura nga dhënësi i informacionit.

Sidoqoftë, kur ka arsye të bazuar për pastrim parash ose financim terrorizmi dhe besohet se ka nevojë urgjente për informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, personi i kontaktit të autoritetit përgjegjës i bën një kërkesë verbale personit të kontaktit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kërkesa të tilla duhet të dokumentohen brenda tri ditëve me anë të një letre me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të japë të gjithë informacionin që disponon, të cilin është e lejuar me ligj ta ndajë me juridiksione të huaja. Nëse ligji shqiptar e kufizon komunikimin e një pjese të informacionit (neni 15 i ligjit), atëherë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të identifikojë qartësisht këtë informacion në përgjigjen e vet (me shkrim ose me telefon) tek autoriteti përgjegjës.

Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë dokumenteve, të dhënave dhe të informacionit të marrë nga autoriteti përgjegjës; çdo nxjerrje e paautorizuar e këtij informacioni e bën punonjësën subjekt të përgjegjësisë penale dhe administrative.

Moszbatimi i kërkesave të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave në rastet kur nuk përbën vepër penale përbën shkelje administrative dhe dënohet me gjobë sipas përcaktimeve në nenin 14 të ligjit.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA I
MODELE TË DYSHIMTA TË PËRDORURA SI STANDARDE NDËRKOMBETARE
ORIENTUESE PËR ZBULIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE TË FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT

LISTA E INDIKATORËVE TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Lista e mëposhtme jep shembuj të përgjithshëm të llojit të aktivitetit të taksapaguesit, i cili duhet kontrolluar nga inspektori i taksave gjatë inspektimit të taksapaguesit:

